

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1.	11.02.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me çmimin e produkteve ushqimore.	11.02.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se Autoriteti i Konkurrencës ka hapur në fund të vitit 2025 një procedurë monitorimi për produktet e shportës, duke u fokusuar tek supermarketet. Autoriteti i Konkurrencës është në proces analizimi të trendit të çmimeve, për të vlerësuar dinamikën e tregut dhe për të identifikuar nëse ka elementë, që mund të rezultojnë në sjellje të mundshme në kundërshtim me rregullat e konkurrencës. Çdo vlerësim konkret do të bëhet në përfundim të analizës së plotë dhe në përputhje me procedurat ligjore, në këndvështrim të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.	E plotë	Nuk ka
2.	20.02.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me proceset e emërimit/zgjedhjes së zyrtarëve të nivelit të mesëm	27.02.2026	Kthim përgjigje duke bërë me dije se për periudhën 01.09.2025 deri tani, Autoriteti i Konkurrencës nuk ka pasur vende të lira pune në pozicione të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues të	E plotë	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		dhe të lartë drejtues, CV-të dhe masat administrative në zbatim të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.		shërbimit civil. Procedurat e ndjekura në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil, për vendet vakante të shpallura, gjenden të publikuara në faqen zyrtare, sipas linkut https://caa.gov.al/publication-s-category/vende-vakante2/ . Për sa i përket masave administrative në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, gjatë periudhës 01.09.2025 deri tani, Autoriteti i Konkurrencës nuk ka marrë masa administrative në zbatim të ligjit nr. 138/2015, ndaj zyrtarëve të zgjedhur, të emëruar apo stafit drejtues. Në lidhje me transparencën e të emëruarve/zgjedhurve ju bëjme me dije se në faqen zyrtare të institucionit gjenden të publikuara përmbledhje të jetëshkrimit të anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës, si dhe drejtorëve të drejtorive, sipas linkut https://caa.gov.al/autoriteti-i-konkurrences/organizimi/ .		
3.	18.03.2026	Kërkesë për informacion mbi mënyrat zyrtare të ankesës mbi çmimet e fryra dhe të pajustifikuara të biletave të transportit publik ndërqytetas Tiranë-Bulqizë dhe anasjelltas.	19.03.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se në lidhje me ankesat mund të plotësoni formularin, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës, linku bashkëlidhur https://caa.gov.al/laws/formular-i-ankeses/ , ose mund të paraqiteni pranë ambienteve të institucionit tonë, në adresën rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Kati IV, Tiranë, 1004, orari e hënë – e enjte 08:00 –	E plotë	Nuk ka

				16:30 dhe e premte 08:00 – 14:00.		
4.	08.04.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me dy operatorët e shërbimeve celulare, mbi përfshirjen në termat dhe kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit, të drejtën për të indeksuar çmimet me normën e inflacionit për vitin paraardhës.	10.04.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1226, datë 18.11.2025, ka vendosur hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare. Procedura e hetimit është aktualisht në vijim dhe Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës do të vlerësojë edhe aplikimin e normës së IÇK (Indeksit të Çmimeve të Konsumit), në kuptim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.	E plotë	Nuk ka
5.	15.04.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me monitorimin e tregut të karburanteve, si dhe gjetjet në përfundim të këtij monitorimi.	27.04.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të kompetencave të tij, sipas ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka ngritur një grup pune për monitorimin e tregut me shumicë dhe pakicë të karburanteve, proces i cili është në vijim. Në rast se gjatë këtij procesi evidentohen indicie apo shenja të kufizimit të konkurrencës, Sekretariati i porpozon Komisionit të Konkurrencës ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm, përfshirë edhe fillimin e procedurave hetimore, në përputhje me parashikimet e ligjit. Nga ana tjetër ju bëjmë me dije se aktualisht funksionon Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit, i krijuar me akt	E plotë	Nuk ka

				normativ, publikuar në Fletoren Zyrtare sipas linkut https://qbz.gov.al/share/O99XnRyLQgeJduEXUKQ5cg .		
6.	23.04.2026	Kërkesë për informacion mbi korrigjimin e të dhënave personale, publikuar në Vendimin nr. 996 të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në parimin e minimizimit të të dhënave, sipas ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale".	28.04.2026	Kthim përgjigje duke bërë me dije se kërkesa juaj do të vlerësohet nga ana e Autoritetit të Konkurrencës dhe në përfundim, do të keni një përgjigje zyrtare.	E plotë	Nuk ka
7.	28.04.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me afatin e përfundimit të procesit të monitorimit në tregun e karburanteve, vënien në dispozicion të gjetjeve të deritanishme, si dhe nisur nga fakti që operatorët në treg ofrojnë çmime identike, duke u rreshtuar në kufirin maksimal të përcaktuar nga Bordi i Transparencës, a do të ketë një procedurë të mirëfilltë hetimore.	29.04.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se raportet dhe analizat e monitorimit të hartuara nga strukturat teknike të Autoritetit përbëjnë dokumente të brendshme pune, të përgatitura në kuadër të ushtrimit të kompetencave hetimore dhe analitike të institucionit. Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, nuk imponon detyrimin për publikimin e dokumenteve të brendshme përgatitore, analizave paraprake apo materialeve që lidhen me procese vlerësimi të papërfunduara, vecanërisht kur publikimi i tyre mund të çenojë efektivitetin e proceseve administrative dhe funksionin mbikëqyrës të institucionit. Proceset e monitorimit dhe analizës zhvillohen në varësi të kompleksitetit të tregut, volumit të informacionit që administrohet dhe nevojës për verifike shtesë. Për rrjedhojë,	E plotë	Nuk ka

				ato nuk i nënshtrohen afateve fikse të paracaktuara për përfundim. Autoriteti i Konkurrencës ushtron në mënyrë të vazhdueshme kompetencat e veta monitoruese mbi tregje me ndjeshmëri të lartë për konsumatorin, përfshirë dhe tregun e karburanteve, dhe vlerësimi nëse një monitorim do të çojë ose jo në hapjen e një procedure hetimore është kompetencë ekskluzive e tij. Gjithashtu, në rast se keni prova konkrete për bashkëpunim midis operatorëve jo vetëm në këtë treg, por në çdo treg, patjetër që do të vlerësonim shumë bashkëpunimin tuaj.		
8.	22.07.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 1280, datë 27.03.2026, për hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të cigareve, konkretisht vënien në dispozicion të raportit të hetimit paraprak, si dhe vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës.	30.07.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se në praktikën evropiane, raportet hetimore të autoriteteve të konkurrencës, nuk konsiderohen dokumente që u jepen palëve të treta sipas kërkesave për të drejtën e informimit, edhe nëse hiqen të dhënat konfidenciale. Kjo nuk lidhet vetëm me mbrojtjen e sekreteve tregtare, por edhe me mbrojtjen e efektivitetit të hetimit dhe të procesit vendimmarrës të autoritetit. Pas miratimit të vendimit përfundimtar, mund t'ju vendoset në dispozicion versioni jo konfidencial, por jo raporti hetimor. Kjo qasje është në përputhje me praktikën e Komisionit Evropian dhe me jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së, e cila e konsideron dosjen hetimore të konkurrencës si një kategori	E kufizuar	Nuk ka

				dokumentesh që gëzon një mbrojtje të veçantë kundër zbulimit për publikun.		
9.	31.07.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me vendimet e Komisionit të Konkurrencës për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj bankave në tregun e sigurimit të jetës për kreditë, si dhe vënien në dispozicion të raportit të hetimit të thelluar, relacionit, analizës juridike dhe procesverbaleve të mbledhjeve ku janë shqyrtuar këto vendime.	13.08.2026	Kthim përgjigje, duke bërë me dije se lidhur me hetimin e thelluar në tregun e sigurimit të jetës për kredi, vendimet përmbajnë vlerësimin e plotë të Komisionit të Konkurrencës lidhur me bazën ligjore të masave dhe detyrimeve të vendosura; zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; analizën e fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, si dhe arsyetimin mbi përfundimet e arritura për ndërmarrjet objekt hetimi. Autoriteti i Konkurrencës, kur bëhet fjalë për procedurat hetimore dhe përfundimet e tyre, shprehet zyrtarisht nëpërmjet vendimit të Komisionit të Konkurrencës. Për rrjedhojë, qendrimi institucional dhe arsyetimi juridik e ekonomik i Autoritetit për çështjet e parashtruara në kërkesën për informacion, janë ato të pasqyruara në vendimet përkatëse, të cilat përbëjnë aktin zyrtar dhe përfundimtar të procedurës. Vendimet janë të publikuara dhe mund të konsultohen në faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës, në rubrikën përkatëse. Në lidhje me kërkesën për të sqaruar bazën ligjore dhe metodologjinë e përdorur për trajtimin konfidencial të të dhënave, si dhe për anonimizimin në vendimet e	E kufizuar	Nuk ka

				publikuara të vlerave të primeve, komisioneve, përqindjeve dhe të dhënave të tjera, ju bëjmë me dije se trajtimi i informacionit konfidencial të administruar gjatë procedurave të Autoritetit të Konkurrencës, mbështetet ndër të tjera në nenin 30 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Në lidhje me vënien në dispozicion të dokumentacionit të procedurës hetimore, ju bëjmë me dije se në praktikën evropiane, raportet hetimore të autoriteteve të konkurrencës nuk konsiderohen dokumente që u jepen palëve të treta sipas kërkesave për të drejtën e informimit, edhe nëse hiqen të dhënat konfidenciale. Kjo nuk lidhet vetëm me mbrojtjen e sekreteve tregtare, por edhe me mbrojtjen e efektivitetit të hetimit dhe të procesit vendimmarrës të autoritetit.		
--	--	--	--	---	--	--

Nuk ka kërkesa të tjera për informacion të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës.